# DËSHMI ARKIVI

**A-423687**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Një shkëndijë me kosto të larta, duhen miliarda lekë për dëmin mjedisor, sistemimin e tokës dhe për fidanët e rinj – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/nje-shkendije-me-kosto-te-larta-duhen-miliarda-leke-per-demin-mjedisor-sistemimin-e-tokes-dhe-per-fidanet-e-rinj/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:12:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 30 gusht 2026, 10:09:04 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 3f4bb95c2979b099062301bb56def16eca345cad980597f288d06af741d271c0 |
| TEKSTI | dab8f7797ad22319f9716f586ab786d45bc59e532150a06fe4867420f9a006d9 |
| PAMJA | c07b49067b32bdf6f0d9b933fea6cc6107d6cb4986c24c3a6d6cd952e3934738 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 299ad89960f00b12153b9d67bd6bc15b1ebd80c6fb64c0d2a1e509b9c269e4d9 |
| E MËPARSHMJA | 33bb59f43b284e01f54a21944f9693606067fc770de6441493ac049429d10a1b |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/299ad89960f00b12153b9d67bd6bc15b1ebd80c6fb64c0d2a1e509b9c269e4d9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**madhe zjarri dhe për të shkaktuar më pas një dëm të konsiderueshëm mjedisor. Vetëm në vitin 2025, në vend ishin aktive 282 vatra zjarri, të cilat dogjën një sipërfaqe prej afro 15 mijë hektarësh. Sipas Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, shkaktarët kryesorë të këtyre vatrave ishin aktiviteti njerëzor dhe temperaturat ekstreme, ndërsa vlera e dëmit e tejkalon shifrën e 7 miliardë lekëve.**

Pisha, ahu, dushku, lisi, por edhe bredhi dhe gështenja u dogjën masivisht vjet. Që këto sipërfaqe të djegura të rikthehen në jetë, do të duhen dekada.

**“Shumë vite, dekada, pyjet që na janë djegur në njësinë Skërnderbegas kanë qenë pyje prej 7-8 dekadash”, tha Besian Ajazi, kryetar i Bashkisë së Gramshit**

Një nga bashkitë më të prekura vitin e shkuar nga zjarret ishte ajo e Gramshit. Por rigjenerimi i zonave të shkrumbuara gjatë verës së 2025 nuk ka nisur ende.

**“Gjatë kësaj periudhe ne kemi mbjellë më shumë se 7-8 hektarë pyje, në bashkëpunim me aktorë lokalë, por edhe kombëtarë. Vetëm gjatë periudhës janar-mars kemi mbjellë më shumë se 15 mijë rrënjë, ndëra gjatë periudhës 2025-2026 janë afro 35 mijë fidanë të mbjellë në zona të prekura vite më parë nga zjarret. Ndërsa për zjarret e rëna vitin e kaluar jemi në fazën që sapo na ka ardhur nga ministria e linjës miratimi i planit të shfrytëzimit në**

5 **Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit**

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

**këto zona dhe për pak ditë do të nisim edhe procedurën e ankandit, që do të thotë largimi i druve të djegur nga masivet pyjore dhe më pas do të bëjmë mbjelljen e fidanëve të rinj", shtoi Ajazi.**

Për mbjelljen e fidanëve të rinj në këto sipërfaqe të djegura bashkitë zakonisht pranojnë dhurime nga sipërmarrës.

**"Bashkia ka bashkëpunuar me operatorë ekonomikë, me sipërmarrës të ndryshëm, në disa raste ne kemi financuar, në raste të tjera kemi bashkëfinancuar. Pjesa më e madhe e tyre është bashkëpunim i bashkisë me dhurues, vijnë si donacione", tha kryebashkiaku i Gramshit.**

Agjecia Kombëtare e Pyjeve thotë se viti 2025 ishte ndër më problematikët për zjarret në Shqipëri krahasuar me dekadën e fundit. Sipërfaqja e djegur dhe numri i zjarreve janë ndër më të lartat që nga viti 2017. Dëmet më të theksuara janë evidentuar në zonat me pishë, për shkak të ndezshmërisë së lartë të halave dhe rrëshirave, të cilat favorizojnë përhapjen e shpejtë të flakëve dhe përkeqësojnë gjendjen e ekosistemit pyjor.

#Pyjet #zjarr

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



SOCIALE

**Nafta në "flakë", Brent mbi 108 dollar...**

Xhuljana Zhuleku · 11 minuta më parë




SOCIALE

**Rama uron nisjen e vitit të ri shkollor: Nj...**

Xhuljana Zhuleku · 3 orë më parë




SOCIALE

**Gjykata e Vlorës i jep fund bojkotit: Nga e...**

Taulant Halili · 12 Sht

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.